njerzisë në besë. Pra: duhet tobe d. m. th. dorëheqje nga të ligat edhe me sadaka të përgëzohen fukaraja). Kush hyn në xhami: gjen shpëtim edhe naltësi. Kush vete në xhami me xhama-at: mer grua me fat, në ësht i martuar: gëzohet me evlat. Kush falet në xhami: bijt e ti gradohen me dituri.

* * *

Kush bën gusël edhe spastrim: nga gjynahet, borxhet, helmet gjen shpëtim. Në dimër gusli me uj të ftohtë: del hidhërim. Me uj të ngrohtë: vjen shëndet edhe fitim. Abdestin kush nuk e mbaron: dëshira e vonon. Kush e plotëson: dëshirën e trashëgon. Tejemmymi: shënon shpëtim nga hidhërimi.

* * *

Kush sheh Mus-haf: pajoset me dituri. E këndduara ose e dëgjuara mus-haf e Hadith: del kësmet edhe mbarësì. Besmeleja, duàja, *qelime i shehadeti:* shënojnë risk edhe drejtësi. Ziqri, istigfari, tespihu: jet gjatësi. Në ëndër kush shkon imam: gradohet me nishan. Kush falë namaz: forcohet nga farzi. E falura jasht Kiblesë: vjen nga dobësi e fesë. Haxhësija: shënon drejtësi në besë, po për beqarët: martesë.

* * *

Kush sheh xhennet: gjen murad edhe rahmet, kush hyn në xhennet: gjen gëzim edhe shpëtim për jetë. Po të shohish skëterë: ke berë gjynahe të erëta. (Pra: bëj tobe). Qabe, Medine edhe gjith viset e uruara: dalin naltësi. Kohrat e uruar si Ramazan, Xhuma, Bajram; shënojnë mbarësi.

* * *

Pënda: shënon hiqmet, edukatë, mirë veti. Mureqepi: fitim edhe dituri. E derdhura mureqep a ngjyrë: prapësi. Libra: fuqi edhe shpëtim. Kush ha fletën e Mus-hafit a të librës: gjen risk edhe fitim. Libra e lidhur edhe karta: del murat edhe përparim.

(ZOT-i më dijë plot: e di më mirë).

Kur sheh djellë, hënë, yjë, dritë' zjar: ëndra ç'kallzon?

Kush sheh djellë: gjenë nderim edhe gëzim të thellë.

Kush sheh hënë: mer grua, po ta shohë gruaja: mer burrë edhe trashëgon me fëmijë. E para djellin a hënën të turbulluar del fat i shëmtuar. Kush sheh hënën që lindet dëshirën e trashëgon, po t'a shohish mes revet: fati shëmton. Dritën e hënës po ta shohish në shtëpi; të vjen një mirësi, i martuari po të shohë hënë: e ndjek mbarësia po ca dijetarë hënën e quajnë si udhëtim. Kush sheh yjtë mirë: nga vëllezëria sheh hajre, e para yjtë keq: nga vëllezëria vjen keq. Drita del besim edhe mbarësi; erësira: ligësi e prapësi. Kush del nga erësira në dritë: shpëton me ditë. Kush ndes dritë: martohet, në ësht i martuar përgëzohet me evlat, në ësht vobeg: pasohet me fat, në ësht në mërgim: vien në atdhe, në ësht grua: mbetet hamile. Llamba, kandili, qiriri: shënon gëzim, grua evlad edhe fat të mirë.

Zjar i ndriçmë me flagë: ësht bereqet edhe përparim. E ngrohura dimrit në zjar: del fitim. Kush hyn